



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT

Thirrje për aplikim në programin e Doktoraturës në “Shkencat Bujqësore” ofruar nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit

Nga data 18.03.2025 deri më 25.04.2025 fillon , afati i pranimit të kërkesave për regjistrim në Programin e Studimeve të Doktoratës në “Shkencat Bujqësore”, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit për vitin akademik 2024-2025. Kohëzgjatja e këtij programi të doktoratës është nga 3 deri në 5 vite.

Programi i Doktoraturës (Ph.D.) në “Shkencat Bujqësore” në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, mbulon fusha kyçe si prodhimi i kulturave, hortikultura dhe arkitektura e peizazhit, mbrojtja e bimëve, prodhimi shtazor dhe akuakultura e peshkimi. Qëllimi i programit është të përgatisë kërkues, novatorëve dhe ekspertë të aftë që mund të trajtojnë sfidat aktuale dhe të ardhshme në bujqësi. Nëpërmjet kërkimit programi synon të nxisë sisteme bujqësore të qëndrueshme dhe produktive që plotësojnë standartet e sigurisë ushqimore, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe vijueshmërinë ekonomike.

1.Në fushën e prodhimit të kulturave bujqësore kërkimi do të fokusohet në zhvillimin e teknikave novatore të prodhimit të qëndrueshëm të kulturave për të rritur rendimente duke minimizuar ndikimin në mjedis. Përmirësimin e varieteteve tolerante ndaj stresit, rezisten të ndaj insekteve ilësinë ushqyese nëpërmjet teknikave të përparuar të bioteknologjisë. Optimizimi i përdorimit të burimeve natyrore si uji, lëndët ushqyese të tokës dhe energjia janë gjithashtu fokusi i kërkimeve për të siguruar intensifikimin e qëndrueshëm të bujqësisë.

2. Hortikulturë dhe Arkitekturën e Peisazhit

Kërkimi do të fokusohet në zhvillimin e kulturave rezistente ndaj ndryshimeve klimatike dhe sistemeve të qëndrueshme të prodhimit. Projektimin dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra dhe peisazheve që mbështesin biodiversitetin , risin bujqësinë urbane dhe kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Integrimin e praktikave hortikulturore në mjediset urbane dhe peri-urbane për prodhimin dhe shërbimet ekologjike kulturore.

3.Mbrojtja e Bimëve

Kërkimi do të fokusohet në zhvillimin e strategjive të integruara për menaxhimin e insekteve dhe sëmundjeve që zvogëlojnë varësinë ndaj pesti ideve apo kimikateve. Gjithashtu kërkimi do të synojë të evidentojë zhvillimin e sëmundjeve të reja të bimëve, spe iet invazive dhe kërkënimet që lidhen me klimën. Nëpërmjet kërkimit do të eksperimentohen përdorimet e agjentëve të biokontrollit dhe praktikat e bujqësisë orgnaike që mbështesin mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e kulturave.

4. Zootekni dhe Akuakulturë e Peshkim

Qëllimi i kërkimit në këto drejtime do të jetë përmirësimi i sistemeve të prodhimit të kafshëve të fermës dhe akuakulturës, inovacioni në teknikat e mbarështimit, të ushqyerit dhe të menaxhimit të shëndetit për prodhim të lartë dhe mirëqenies së kafshëve. Hulumtimi në sistemet e qëndrueshme të akuakulturës dhe programet e mbarështimit të peshkimit të qëndrueshëm. Zhvillimi i sistemeve të integruara bimë-kafshë-peshq për të përmirësuar efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe qëndrueshmërinë e aktiviteve. Në program adresohen gjithashtu sfidat që lidhen me sëmundjet zoonotike, rezisten në antimikrobiale dhe emetimet e gazrave serrë nga bagëtia.

A. Kërkesat për regjistrimin e kandidatëve në Programin e Doktoratës “Shkencat Bujqësore”.

Për të kryer regjistrimin në programin e studimit të doktoraturës në “Shken at Bujqësore”, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- a. Të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo të jetë personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar
- b. Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë një diplomë të ikilit të dytë “Master i Shkenave”, ose një diplomë ekuivalente me MS në Shken at Mjedisore ose degë të përafërta si psh: Shken a Bujqësore, Shken at e Natyrës, Gjeoshken a, Shken a Biologjike dhe Kimike të aplikuara etj.
- c. Kandidati duhet të ketë një vlerësim mesatar të përgjithshëm me notë mesatare mbi 8
- d. Të ketë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja: **anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht**
- e. Për kandidatët që kanë fituar një diplomë pas përfundimit të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
- f. Të ketë dy rekomadime nga personel akademik që kanë titullin akademik “Profesor i Asistenti” ose “Profesor”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit
- g. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo të shkelje të rregullave kundër plagjaturës,
- h. Vetëdeklarim i aplikantit se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

B. Dokumentat për aplikim

- Personat e interesuar për të ndjekur programin e studimit të doktoratës në “Shken at Mjedisore” duhet të dorëzojnë në Dekanatin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, nga **18 Mars 2025** deri në **21 Prill 2025**, dosjen e ila duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:
- Kërkesë personale drejtuar njësisë bazë ose kryesore, përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të iklit të tretë.
 - Curri ulum Vitae.
 - Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
 - Çertifikatë lindjeje, si dhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës.
 - Dy fotografi.
 - Dy rekomadime nga personel akademik që kanë titullin akademik “Profesor i Asotuar” ose “Profesor”.
 - Dëshmi origjinale ose të noterizuar të gjuhës së huaj (njëra nga gjuhët e sipërpërmendura në kritere, niveli B2). Dokumenti i njohjes së gjuhës së huaj mund të jetë një çertifikatë, diplomë ose dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testeve ndërkombëtare, të ilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre.
 - Një deklaratë nëpërmjet së ilës pranohet shlyerja e të gjitha detyrimet finan iare, lidhur me koston e studimeve sipas për aktimeve të bëra nga strukturat e UBT-së.
 - Një propozim në të ilin të për aktohet fusha me interes për ndjekjen e studimeve të iklit të tretë se bashku me emrin e udhëheqësit shken or.
 - Për aplikantët që nuk janë staf akademik i njësive përbërëse të UBT-së, përveç pagesës së tarifës zyrtare, kërkohet konfirmimi/dokumentimi që vërteton përballimin e të gjitha shpenzimeve dhe kostove të studimeve të doktoratës, nëpërmjet depozitimit të projektit shken or të fituar apo ndonjë kontrate finan iare të vlefshme, sipas për aktimeve të bëra nga strukturat e UBT-së.
 - Vërtetim që është personel akademik në njërën prej njësive bazë të UBT-së, ose që kandidati ka angazhim akademik pranë një institu ioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institu ion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
 - Mandat pagese për tarifën e aplikimit (2000 Lek).
 - Vetëdeklarim i aplikimit se do të zbatojë standardet shken ore dhe etike.

Dokumentat duhet të dorëzohen tek Zv/Dekani për Shken ën dhe Projektet në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit **Prof. Dr. Lumturi Papa** adresa e e-mail-it: **lpapa@ubt.edu.al**
Tel: **0674400239**